

SHËNIME SHPJEGUESE

Për periudhën: 01 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor 2019

Në këtë aneks paraqiten informacionet shpjeguese në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të njësisë ekonomike Klodiodashpk.

Njësia ekonomike Klodioda shpk, e krijuar më datë 01.06.2005, ushtron aktivitetin e saj në fushën e projektimit, supervizionit dhe kolaudimit, me adresë Rruga e Barrikadave, Nr. 118 Tirane.

Për periudhën 01 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor 2019 është përgatitur dhe paraqitur paketa e plotë e pasqyrave financiare, të cilat japin njëpamjetë vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë gjatë kësaj periudhe.

Përgatitja dhe paraqitja e tyre, e cila është përgjegjësi e Drejtimit të njësisë, është realizuar mbështetur në Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK). Gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Monedha e përdorur është monedha Lek. Rrumbullakime të vlerave nuk ka. Ngjarjet dhe transaksionet janë evidentuar gjatë gjithë periudhës ushtrimore në përputhje me: SKK Nr. 1 'Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare' dhe SKK Nr. 2 'Paraqitja e pasqyrave financiare' si dhe çdo standard tjetër kombëtar në përputhje me natyrën e ngjarjeve apo transaksioneve të cilat në mënyrë të hollësishme do të jepen në vijim të

• Shënime shpjeguese në lidhje me zërat e paraqitur në pasqyrën BILANC

Paraqitja e kësaj pasqyre është mbështur në paketën e plotë të standardeve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Në vijim do të jepen informacionet shpjeguese për zërat përbërës të saj.

I. Informacione Shpjeguese për AKTIVET

Totali i aktiveve të paraqitura në pasqyrën e Bilancit është në vlerën 158,367,424 lekë, detajimi nëpërmjet informacioneve shpjeguese i të cilit paraqitet si vijon:

□ Informacione shpjeguese për AKTIVET AFATSHKURTRA

Aktivet afatshkurtra janë paraqitur në vlerën 54,752,094 lekë, të cilat përbëhen nga:

Zëri, Aktive Monetare në vlerën 29,609,546 leke, e cila paraqitet në menyre të detajuar si me poshte:

- Arka paraqitet në vlerën 26,528 lekë.

- Banka paraqitet në vlerën 29,583,018 lekë.

Zëri, Llogari/Kërkesa të arkëtueshme në vlerën 17,444,104 lekë, pëfshihen të gjitha të drejtat e njësisë ndaj të tretëve. Zeri "Te tjera" përfaqëson parapagimin e tatimit fitimit në vlerën 4,083,122 leke dhe TVSH e kreditueshme në vlerën 3,615,323 leke.

□ Informacione shpjeguese për AKTIVET AFATGJATA materiale

Aktivet afatgjata janë paraqitur në vlerën 8,493,001 lekë, të cilat përbëhen nga:

- Zeri, Aktive afatgjata materiale Ndertesa në vlerën neto 6,026,760 lekë.

- Zeri, Aktive afatgjata materiale Makineri dhe Pajisje në vlerën neto 2,466,241 lekë.

Amortizimi është llogaritur me metodën mbi vlerën e mbetur dhe paraqitet në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve në vlerën 981,459 lekë.

- Zeri Aktive Afatgjat Materiale në Proces paraqitet në vlerën 95,122,329 lekë.

II. Informacione Shpjeguese për DETYRIMET

Detyrimet e paraqitura në pasqyrën e Bilancit janë në vlerën 158,367,424 ekë.

Detajimi jepet nëpërmjet informacioneve shpjeguese si vijon:

Informacione shpjeguese për DETYRIMET AFATSHKURTRA

Detyrimet afatshkurtra janë paraqitur në total në vlerën 21,466,467 lekë, dhe përbëhen nga detyrimet ndaj furnitorëve, punonjësve, detyrime ndaj shtetit për tatime dhe taksa:

Detyrimet ndaj furnitorëve në vlerën 20,372,236 lekë.

Detyrimet ndaj punonjësve në vlerën 798,192 lekë, përfaqësojnë detyrimin për paga te prapambetura.

Detyrimet tatimore përfaqësojnë detyrimet si me poshte vijon:

Elementi	Ref.	Vlera në lekë
Sigurime Shoqërore	431	218,136
Tatimmbitëardhurat personale	442	77,903
TVSH per t'u paguar	4453	

Tat fitimi

per t'u paguar

Informacione shpjeguese për DETYRIMET AFATGJATA

Detyrimet afatgjata janë paraqitur në vlerën 19,748,499lekë, të cilat përbëhen ngaTe drejta dhe detyrime ndaj ortakeve.

III. Informacione Shpjeguese për KAPITALIN

Kapitali i paraqitur në vlerën 117,152,459 lekë, përfshin tepricen kreditore të llogarisë Fitimi (Humbja) e vitit në vlerën 12,008,200 lekë, dhe kapitalin themeltar 100,000 lekë me gjithë zmadhimin e kapitalit gjate vitit 2015 ne vleren 48,900,000 lek dhe rezervat ligjore 617,396 lek si dhe rezerven per investime ne vleren 55,526,863, i cili paraqet fitimin e vitit 2016, fitimin e vitit 2017 dhe fitimin e vitit 2018.

Informacione shpjeguese për zërin FITIME TË VITIT

Zëri, Fitime/Humbje të vitit paraqet rezultatine periudhës rrjedhëse ushtrimore të njësisë raportuese ashtu siç rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dheqëështëfitim në vlerën 12,008,200 lekë.

• Shënime shpjeguese në lidhje me zërat e paraqitur në pasqyrën TË ARDHURA DHE SHPENZIME

Pasqyra të Ardhura dhe Shpenzime është paraqitur bazuar në klasifikimin e shpenzimeve sipas natyrës. Në këtë periudhë ushtrimore ka rezultuar njëfitim në vlerën 12,008,200 lekë.

Informacioni shpjegues për zërin Shitje neto

Shitjet neto rezultojnë ne vlerën 22,095,350 lekë.

Gjatë periudhës ushtrimore janë realizuar:

Zëri, Kosto e punës, i cili është i paraqitur në vlerën 11,164,690 lekë, dhe që përbëhet nga:

1. Shuma, Pagat e personelit gjatë periudhës ushtrimore 01.01.2019-31.12.2019 në vlerën 9,603,361 lekë.

2. Shuma, Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore gjatë periudhës ushtrimore 01.01.2019-31.12.2019, në vlerën 1,561,328 lekë.

Zëri, Amortizimet dhe zhvleresimet në vlerën 981,459 lekë.

Zëri, Shpenzime të tjera shfrytëzimi paraqitur në vlerën 20,135,500 lekë, përfaqëson shpenzime të cilat janë kryer për zhvillimin e aktivitetit të njësisë ekonomike.

Ne zerin te ardhura te tjera jane paraqitur:

- Te ardhura neto nga interesat e arketuara ne vleren 67,357 lek dhe te ardhura nga kursi i kembimit ne vleren 176,828 lek.

-

• Shënime shpjeguese në lidhje me zërat e paraqitur në pasqyrën e FLUKSEVE MONETARE

Në pasqyrën e flukseve monetare janë paraqitur flukset hyrëse dhe dalëse të mjeteve monetare në njësinë ekonomike gjatë periudhës korrente kontabël. Paraqitja është bërë sipas metodës indirekte.

Gjatëperiudhës kontabël ka rezultuar:

- Fluksi i parasë nga aktiviteti i shfrytëzimit në vlerën 1,484,277 lekë.
- Fluksi i parase nga veprimtaria investuese në vlerën (298,150) lekë.
- Fluksi i parase nga veprimtaria financiare në vlerën (255,472) leke.

• Shënime shpjeguese në lidhje me zërat e paraqitur në pasqyrën e NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT

Ndryshimet në zërin Kapital kanë ardhur si rezultat i:

1. Fitimt të periudhës ushtrimore në vlerën 1,396,907lekë.
2. Kalimi i fitimit te vitit 2017 ne vleren 30,755,865 lek ne rezerva investimi

Informacionet shpjeguese për zërat e mësipërm janë dhënë në pasqyrën e Bilancit.

Drejtuesi
Ylli Karapici
Administrator

Hartuesi
Rezarta Karapici



A handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke extending to the right.